




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI

Drejtoria e Arsimit
Nr. 07- Zyrtarisht

Datë: 14.08.2019

Në bazë të nenit 5, shkronja b) të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, neni 17, shkronja h) të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASH, dhe Vendimi Për Kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasën e 10-të, për vitin shkollor 2020/2021 numër 01/3-70, datë 07.08.2020

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT (DKA) SHPALL

K O N K U R S

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZIT DHE SHKOLLËN PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2020/2021

I. Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri" në Deçan


Drejtimit:	Nr. i paraleleve	Nr. nxënësve në Paralele	Gjithsej
1. Shkenca Natyrore	6	30	180 nxënës
2. Shkenca Shoqërore -gjuhësore	5	30	150 nxënës
Gjithsej:	11	30	330 nxënës

II. SH. M. P. "Tafil Kasumaj" në Deçan

DREJTIMI: MJEKËSISË 1 (NJË) PARALELE TË NDARË NGA SHKOLLA E MJEKËSISË NË PEJË

PROFILI: INFERMIER I PËRGJITHSHËM

1 PARALELE 32 NXËNËS



DREJTIMI: ELEKTRONIKË

PROFILI ARSIMOR: INFORMATIKË
PROFILI ARSIMOR: ELEKTROINSTALUES

2 PARALELE 48 NXËNËS
1 PARALELE 24 NXËNËS

DREJTIMI: MEKATRONIKË

PROFILI ARSIMOR: MEKATRONIKË

1 PARALELE 24 NXËNËS

DREJTIMI: MAKINERI

PROFILI ARSIMOR: AUTOMEKANIK
PROFILI ARSIMOR: INSTALUES I UJIT DHE KANALIZIMIT

1 PARALELE 24 NXËNËS
1 PARALELE 24 NXËNËS

DREJTIMI: EKONOMI

PROFILI ARSIMOR: KONTABILITET
PROFILI ARSIMOR: TREGTAR ME SHUMICË DHE PAKICË

1 PARALELE 32 NXËNËS
1 PARALELE 32 NXËNËS

DREJTIMI: HOTELERI

PROFILI ARSIMOR: ASISTEN HOTELI
PROFILI ARSIMOR: KUZHINJER

1 PARALELE 24 NXËNËS
1 PARALELE 24 NXËNËS

GJITHSEJ: 11 PARALELE

288 NXËNËS

Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazit dhe të shkollës profesionale, për vitin shkollor 2020/2021, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët kanë mbaruar arsimimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët kanë mbaruar klasën e nëntë (IX) jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASH dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaz dhe shkollën profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes ose Ekstraktin e lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnazin dhe shkollën profesionale për vitin shkollor 2020/2021, bëhet më datën 17 – 21 gusht 201 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësit dëshirojnë të regjistrohen duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallën në shkollat përkatëse më datën: 24 gusht 2020.

Në shkollat ku nuk plotësohet numëri i nxënësve, aplikimi i nxënësve mund të vazhdojë deri më datën 26 gusht 2020

Rezultatet shpallën më 28 gusht 2020

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet më datën: 24 përkatësisht më 28 gusht 2020.

Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (60%) 60 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare (40%) 40 pikë
3. Kriteri i lëndëve nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 e më lartë (Së pari gjendet mesatarja 4 lëndëve prioritet veç e veç, pastaj mesatarja e mesatares së këtyre lëndëve).

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

3. Lëndët prioritare për drejtimet përkatëse

- **Gjimnazi “Vëllezërit Frashëri”**
- **Drejtimi i shkencave natyrore**
 - Lënda I – Fizikë
 - Lënda II – Kimi
 - Lënda III – Biologji
 - Lënda IV – Matematikë
- **Drejtimi i shkencave shoqërore**
 - Lënda I – Gjuhë amtare
 - Lënda II – Gjuhë angleze
 - Lënda III – Histori
 - Lënda IV – Gjeografi
- **Shkolla e Mesme Teknike “Tafil Kasumaj”**
- **Drejtimet**
- **Elektronikë – Profili: Informatikë, Elektroinstalues**
 - Lënda I – Fizikë
 - Lënda II – Kimi
 - Lënda III – Matematikë
 - Lënda IV – TIK
- **Ekonomi – Profili: Kontabilitet, Tregti më shumicë dha pakicë**
 - Lënda I – Gjuhë amtare
 - Lënda II – Gjeografi
 - Lënda III – Matematikë
 - Lënda IV – TIK
- **Mekatronikë – Profili: Mekatronikë**
 - Lënda I – Fizikë
 - Lënda II – Kimi

- Lënda III – Matematikë
- Lënda IV – TIK
- **Mjekësi – Profili: Infermier i përgjithshëm**
 - Lënda I – Fizikë
 - Lënda II – Kimi
 - Lënda III – Biologji
 - Lënda IV – Gjuhë amtare
- **Hoteleri – Profili: Asistent hoteli, Kuzhinier**
 - Lënda I – Gjuhë amtare
 - Lënda II – Gjuhë angleze
 - Lënda III – Histori
 - Lënda IV – Gjeografi
- **Makineri – Profili: Automekanik, Instalues i ujit dhe kanalizimit**
 - Lënda I – Gjuhë amtare
 - Lënda II – Gjuhë angleze
 - Lënda III – Histori
 - Lënda IV – Gjeografi

AFATI I ANKESAVE

Kandidati/ja i/e refuzuar dhe i/e cili/a dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit kanë të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqesin ankesë drejtorisë së shkollës.

Vërejtje: mosparaqitja e ankesës në afatin zyrtar, në shkollën përkatëse, nënkupton humbjen e të drejtës për ankesë në shkallën e dytë në Drejtorinë e Arsimit (DKA) apo në Ministrinë e Arsimit, Shkencës (MASH). DKA dhe MASH nuk i shqyrtojnë asnjë ankesë nëse ajo nuk është shqyrtuar nga komisioni përkatës i shkollës

Drejtori i DKA-së
Bekim Vishaj

